

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije	
Ministry of Finance	
Arkiva - Arhiva - Archive	
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	01/4/40
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	211-2/2023
Nr. i faqeve Kraji stranica No. pages:	08.02.2023
PRISHTINE/A	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

<b>DATE/A:</b>	08.02.2023
<b>REFERENC-Ë:</b>	/2023
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Zyrtarët Kryesor Administrativ të Organizatave Buxhetore
<b>CC:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Qarkore rreth zbatimit të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës



Të nderuar,

Me qëllim të zbatimit të dispozitave ligjore të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës (këtëj e tutje referuar edhe si **'Rregullorja'**) dhe në kontekst të zbatimit të afateve ligjore për sigurimin e kompensimit të shtesës për kategoritë të cilët i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të Rregullores, në vijim mund të gjeni Qarkoren me anë të së cilës ofrohen instruksionet e nevojshme që duhet ndjekur nga institucionet për t'u siguruar zbatimi i këtij akti nënligjor.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve mbetet në dispozicionin tuaj për t'iu ofruar sqarime shtesë.

Me respekt!

**Qarkore rreth zbatimit të Rregullore (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për  
Kushte të Tregut të Punës**

1. Rregullorja (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, tashmë në fuqi, përcakton profesionet, kushtet dhe procedurat për përfitimin e shtesës për kushte të tregut.
2. Në këtë kuptim, Rregullorja specifikon se profesionet për të cilat mund të përfitohet shtesa për kushte të tregut të punës janë profesionet vijuese:
  - 2.1. Profesionet deficitare në fushën e teknologjisë informative;
  - 2.2. Profesionet deficitare në fushën e aviacionit dhe navigimit ajror;
  - 2.3. Profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkë-financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
  - 2.4. Specialistët shëndetësor në profesione deficitare, ashtu siç përcaktohen nga ministria përkatëse për shëndetësi;
  - 2.5. Pozita tjera të caktuara profesionale deficitare të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve/ve me pagat e rregullta në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur.
3. Dispozitat e Rregullore kanë vendosur një kusht të detyrueshëm që shtesa për kushte të tregut të punës të mund të përfitohet për profesionet e caktuara sipas paragrafit 2 të kësaj Qarkoreje, vetëm atëherë kur plotësohen kumulativisht kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në Rregullore, kur kriteret e veçanta aplikohen për secilin profesion deficitar.
4. Si rezultat i elaborimeve të mësipërme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve udhëzon të gjitha institucionet që vlerësojnë se kanë të punësuar në profesionet e përcaktuara konform Rregullore dhe që i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të dorëzojnë listën e të punësuarve tek Komisioni përgjegjës në e-mail adresën vijuese [kktp@rks-gov.net](mailto:kktp@rks-gov.net) më së largu deri më **16 Shkurt 2022**.
5. Lista e të punësuarve, sipas paragrafit 4 të kësaj Qarkoreje, përpilohet nga njësitë përgjegjëse për burime njerëzore të secilit institucion dhe duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:
  - 5.1. Emrin dhe mbiemrin e nëpunësit civil;
  - 5.2. Pozitën e nëpunësit civil;
  - 5.3. Përshkrimin e detyrave të punës; dhe
  - 5.4. Propozimin e arsyetuar për nivelin e shtesës.
6. Brenda kornizave të vendosura me Rregullore, institucionet mund të kontaktohen nga Komisioni për të marrë informata shtesë rreth kërkesave të parashtruara. Ngjashëm, edhe institucionet udhëzohen që të kontaktojnë Komisionin për çfarëdo kërkesë dhe/apo sqarime që iu nevojitet në përpilimin e listave - në mënyrë që të evitohen vonesat e mundshme dhe të respektohen afatet ligjore të përcaktuara me Rregullore.